



REPUBLIKA E SHqipëRIË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

---

# INVESTIMI NË TITUJ QEVERITARË

---

Pjesëmarrja e investitorëve individualë

# Çfarë janë titujt qeveritarë?

---

- Titujt qeveritarë janë instrumente borxhi të cilët emetohen dhe garantohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë emeton tituj qeveritare rregullisht në treg nëpërmjet ankandeve

## Avantazhet e investimit në tituj qeveritarë



Mbartin risk më të ulët në krahasim me investimet e tjera dhe ndihmojnë në diversifikimin e portofolit të investimit



Kanë kthime me të larta krahasuar me normat e depozitave të bankave të nivelit të dytë për të njëjtin maturitet



Janë të tregtueshëm menjëherë në tregun sekondar

**Kur qeveria  
merr hua?**

---

Financim i defiçitit

**Ardhurat**

<

**Shpenzimet**

## Burimet e Financimit



Tregu i Brendshëm

- Bono Thesari (3M, 6M, 12M)
- Obligacione (2V, 3V, 5V, 7V, 10V, 15V)



Tregu Ndërkombëtar


- Hua për financim projektesh me terma koncensionale/gjysëm-koncensionale
- Mbështetje Buxhetore
- Eurobond
- Kredi nga institucione financiare private

# Mbajtësit e titujve qeveritarë në tregun e brendshëm

T3- 2022

Pjesën më të madhe të titujve qeveritarë e mban sistemi bankar (~63 %)


Individët mbajnë rreth 10% të totalit



# Normat e kthimit

Normat vjetore aktualisht variojnë nga 2.78% (B.Th. 3M) deri në 8.39% (Obl. 15V), por tendenca është në rritje

Normat e kthimit sipas instrumenteve (%)



# Karakteristikat e Bonove të Thesarit

---



Instrumente që tregtohen me zbritje (discount)



Përfitimi nga investimi  
=  
vlera nominale - çmimi i blerjes



Shuma minimale:

- 300.000,00 Lekë
- 2.000 EUR/USD



Çdo investitor i suksesshëm pagan çmimin që ka ofruar (mekanizmi me shume cmime)



Kërkesa konkurruese (ofron shumën dhe yieldin) ose jo-konkurruese (ofron shumën dhe merr yieldin mesatar)

# Karakteristikat e Obligacioneve

---



Tregtohen me “par value”  
(çmimi i blerjes = vlerë  
nominale), me përjashtim të  
rihapjes



Interesi paguhet çdo 6-  
muaj



Shuma minimale:

- 300.000,00 Lekë
- 3.000 EUR/USD



Përdoret mekanizmi uniformë  
(të gjithë ofruesit e  
suksesshëm marrin normën  
cut-off), përveç 3V dhe 5V.

# Procedura e pjesëmarrjes së individëve në ankand

Paraqitja e kërkesave në ankad nëpërmjet **sportelevë të Bankës së Shqipërisë**  
(vetëm për bonot e thesarit në lekë)

01

Hapja e një llogarie  
cash për  
pjesëmarrje në  
ankandin e titujve  
qeveritare, pranë  
bankave të nivelit  
të dytë

02

Derdhja e  
fondeve që do  
të investohen  
në llogarinë e  
hapur për këtë  
qëllim

03

Marrja nga banka  
e nivelit të dytë e  
IBAN-it dhe  
vërtetimit për  
bllokimin e shumës  
për pjesëmarrje në  
ankandet e  
bonove

04

Paraqitja e IBAN-t dhe  
vërtetimit për bllokimin  
e shumës pranë  
sportelevë të Bankës  
së Shqipërisë, për të  
hapur llogarinë dhe  
plotësuar kërkesën për  
pjesëmarrje



# Procedura e pjesëmarrjes së individëve në ankand

Paraqitja e kërkesave nëpërmjet **bankave të nivelit të dytë**  
(për bonot e thesarit dhe obligacionet në lekë dhe valutë)

01

Hapja e një llogarie cash dhe titulli për pjesëmarrje në ankandin e titujve qeveritare, pranë bankave të nivelit të dytë

02

Derdhja e fondeve që do të investohen në llogarinë e hapur për këtë qëllim

03

Të plotësojë kërkesën për pjesëmarrje në ankand


**Aneks**

# Shembull – Bono Thesari

---

- 2022 ● Një individ investon në Bono Thesari 12 mujore me shumë 1 mln Lekë. Çmimi i përcaktuar nga ankandi që do të paguajë është 940,000 Lekë (discount)
- 2023 ● Në maturim investitori merr shumën nominale (1 mln Lekë).  
Fitimi i investitorit para tatimit:  $1,000,000 - 940,000 = 60,000$  lekë  
Fitimi pas tatimit:  $60,000 - (15\% * 60,000) = 51,000$  lekë  
Shuma kthyer në maturim: 991,000 lekë

# Shembull - Obligacione



# Fjalor

## Çmimi i tregtimit

**Par:** Kuponi = Yield (vlera nominale = vleren e tregut)

**Discount:** Kuponi < Yield (vlera nominale > vleren e tregut)

**Premium:** Kuponi > Yield (vlera nominale < vleren e tregut)

**Bono thesari** - Instrumente financiare afatshkurtra me maturim 3, 6 dhe 12 muaj.

**Obligacione** - Instrumente financiare afatmesme dhe afatgjata me maturim 2, 3, 5, 7, 10 dhe 15 vite.

**Ankandet me cmim uniform** - Një ankand në të cilin të gjithë ofruesit e suksesshëm paguajnë për titujt e qeverisë të alokuara në normën cut-off të ankandit.

**Yield** - Norma e kthimit nga investimi në tituj gjatë një periudhe kohe, e shprehur si përqindje.

**Kërkesa konkurruese** - Kërkesat në të cilat shprehet shuma që kërkohet të blihet në ankand si dhe yieldi/marzhi.

**Kërkesa jo konkurruese** - Kërkesat në të cilat shprehet vetëm shuma e titullit që kërkohet të blihet në ankandin e titujve.

**Ankandi me shumë çmime** - Një ankand në të cilin secili ofrues i suksesshëm paguan çmimin që ka ofruar.

**Rihapje** - Emetimi i shumave shtesë të një obligacioni të emetuar më parë, me të njëjtin ISIN, datë maturimi dhe kupon.